



# Christ Is Risen!

Prill, 20 2025  
Protokoll 04/001

Klerit, monastikëve dhe besimtarëve të Kishës Orthodhokse në Amerikë, fëmijët e dashur në Zotin,

Krishti u Ngjall! Vërtet u Ngjall!

“Kjo është dita e zgjedhur dhe e shenjtë, e para e të shtunave, mbreti dhe zoti i ditëve, festa e festave, dita e shenjtë e ditëve të shenjta. Në këtë ditë ne e bekojmë Krishtin përjetësisht.”

Kështu kënduam në Mëngjezore, në këngën e tetë të kanonit të Pashkës. Shën Joan Damaskini, autori i këtij kanoni, e quan këtë ditë “festa e festave,” dhe ndërsa kremtojmë këtë festë të festave, këtë të parën dhe më të madhën ndër festat, mund të shtrojmë një pyetje që duket e thjeshtë: çfarë janë festat dhe pse i kremtojmë?

Kjo pyetje bëhet edhe më e rëndësishme sot, ndërsa bota rreth nesh bëhet gjithnjë e më kaotike dhe e ndërlikuar. Në mes të gjithë këtij ndryshimi dhe zënies me punë, si mund të gjejmë kohë thjesht për të kremtuar dhe për të mos bërë asgjë që duket e dobishme?

Shumë prej nesh e njohin përshëndetjen festive ruse, *s prazdnikom*. Fjalëkyçi këtu është *prazdnik*, që do të thotë festë ose ditë pushimi, që rrjedh nga mbiemri *prazdny*, që do të thotë “bosh,” dhe prej andej “i papunë.” Por kjo boshësi apo papunësi nuk është thjesht një mungesë. Festa ka një përmbajtje pozitive, por kjo përmbajtje nuk është e krijuar nga njeriu: është diçka e bërë nga Zoti, diçka që ne e përjetojmë dhe e vlerësojmë duke pushuar nga veprat tona.

Festa është ditë në të cilën ne pushojmë që Zoti të veprojë; ditë që i zbrazim nga veprat tona që t'i mbushim me kujtimin e veprave të Zotit: veprat e Tij, prania e Tij, lavdia e Tij.

Sepse, siç thotë Zoti, e shtuna është bërë për njeriun, jo njeriu për të shtunën (Marku 2:27). Ne keqpërdorëm vullnetin e lirë, mëkatuam dhe humbëm gëzimin e vazhdueshëm të pranisë së Zotit, duke u mallkuar të punojmë me djersën e ballit (Zanafilla 3:19). Por Zoti, në mëshirën e Tij, na ka

dhënë ditën festive, një ditë në të cilën mund të kthehemi në gjendjen tonë të para-mëkatit, në Eden. Ne lëmë mënjane punën që është rezultat i mëkatit dhe, për të paktën një ditë, i kushtohemi prehjes së vërtetë, asaj që është “e vetmja e nevojshme”: adhurimit në frymë dhe të vërtetë, koha e së cilës po vjen dhe tashmë është (Luka 10:42, Joani 4:23). Siç kënduam në kanon, festa është dita në të cilën ne e bekojmë Krishtin përjetësisht.

Në këtë mënyrë, dita festive bëhet një ikonë e njeriut të hyjnizuar, i mbushur me energjitë hyjnore – veprimi i Zotit, jo i vetvetes. Shenjtorët e zbrazin zemrën, jetën dhe qenien e tyre nga gjithçka tokësore dhe pasionante që Zoti të banojë në to si në tempullin e Tij të shenjtë. Festa është gjithashtu një ikonë e jetës që do të vijë, ku të zgjedhurit nuk do të njohin më mundim apo brengë, por vetëm gëzimin e përhershëm të Mbretërisë, adhurimin e pandërprerë në qiell të Trinisë së Shenjtë.

Prandaj, në këtë të parën e të shtunave, lutem që të gjithë të lëmë mënjane mundimet e Kreshmës dhe të gëzohemi në ditën që Zoti ka bërë — E Diela e Ndrirshme, Pashka e Tij e madhe dhe e shenjtë (Psalmi 117:24). Duke ndjekur gjurmët e Mësuesit tonë vetëzbrasës, ne punuam për gjashtë javë për të pastruar zemrat dhe jetët tona nga gjithçka që nuk i përket Zotit, jo që të mbetemi bosh, por që të mbushemi, sipas masës dhe kapacitetit tonë, me hirin që Krishti sjell në botë përmes Ngjalljes së Tij jetë-dhënëse.

Krishti pushoi pas gjashtë ditëve të krijimit, dhe tani, pas gjashtë javëve të Kreshmës, na thërret të hyjmë në pushimin e Tij, të gjejmë paqen tonë në Të dhe në shpëtimin e madh që Ai ka kryer për ne mbi Kryq.

Krishti u Ngjall, Paqja e Perëndisë, vetë Paqja Hyjnore, dhe kështu, në mes të një bote të zënë dhe që vërtitet, ne gjejmë paqen e përjetshme në këtë festë të festave.

Qoftë hiri, paqja dhe gëzimi i Ngjalljes së Tij me ju të gjithë, gjithmonë, tani dhe në shekuj të shekujve. Duke ju përshëndetur me gëzim festiv dhe hare Pashkale, dhe duke ju siguruar për lutjet e mia dhe bekimin primacial, mbetem,

I juaji në Krishtin,



† Tikhoni  
Kryepiskop i Uashingtonit  
Mitropolit i gjithë Amerikës dhe Kanadasë